



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KE.nr. 403/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit “A...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson I.O.S avokate nga Prishtina, kundër të paditurës N.T.P “1...”, NRB: ....., B.I, me pronar E.Rr, me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson I.R avokat nga Gjilani, me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 18.367.12 €, jashtë seancës, me datë 22.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “A...” Sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura N.T.P “1...”, që paditësit të ia paguaj shumën prej 18.367.12 € (tetëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e dymbëdhjetë cent), në emër të borxhit, me kamatë ligjore nga data e dorëzimit të propozimit për përmbarim 05.09.2013 e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në tërësi SI E PABAZUAR.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “A...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, përmes avokates I.O.S, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjen Ekonomike, në cilësinë e kreditorit me datën 05.09.2013, ka paraqitur propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave

për pagesë të borxhit në shumën prej 18.367.12 €, me kamatë ligjore, ndaj tani të paditurës - debitorit N.T.P “1...”, me seli në Gjilan.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje juridike ka vendosur sipas Aktgjykimit III.Ek.nr. 645/13 të datës 05.05.2017. Ndërsa sipas aktvendimit Ac. nr. 171/2017 të datës 06.11.2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, janë aprovuar ankesat e paditësit dhe të paditurës dhe është prishur aktgjykimi III.Ek.nr. 645/13 i datës 05.05.2017 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, duke marr numrin e ri Ek.nr. 671/19.

Lënda me numër EK.nr.671/19 e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike është transferuar për shqyrtim në Gjykatën Komerciale, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe e njëjta ka marr numrin e ri KE.nr 403/22.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka caktuar mbajtjen e seancës përgatitore lidhur me këtë çështje juridike për datën 01.12.2022, ndërsa e autorizuar e paditësit, përmes parashtrësës së datës 21.11.2022 e ka njoftuar Gjykatën se meqë paditësi ka përfunduar çdo aktivitet biznesi në Kosovë dhe është në proces të mbylljes së Kompanisë, ka deklaruar se nuk do ta vazhdon procesin gjyqësor në çështjen juridike të paditësit ndaj të paditurit të iniciuar sipas propozimit përmbarrimor të paditësit që në vitin 2013 dhe i ka propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 149 të LPK-së, të vendos përshtatshmërisht me heqjen dorë të paditësit nga kërkesëpadia.

Sipas nenit 149 par. 1 të LPK-së, përcaktohet se “ *Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë), ndërsa me par. 2 të këtij neni përcaktohet se “ Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”.*

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrës së të autorizuarës së paditësit dhe meqenëse në rastin konkret bëhet fjalë për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, në kuptim të nenit 149 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 403/22, datë 22.11.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.